



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.136

19 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.628, datë 3.10.2007

Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë
Elektrike 3735

Vendim i ERE
nr.57, datë 11.10.2007

Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të
centralit elektrik, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ky
central shoqërisë “Remi” sh.p.k..... 3755

VENDIM
Nr.628, datë 3.10.2007

PËR MIRATIMIN E MODELIT SHQIPTAR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr.539, datë 12.8.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit transitor të tregut të energjisë elektrike”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MODELI SHQIPTAR I TREGUT

Hyrje

Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, përbën një nga hapat e rëndësishëm drejt konsolidimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Ky miratim është pjesë e reformës që ka ndërmarrë Qeveria Shqiptare për ristrukturimin e gjithë sektorit elektroenergjetik, mbështetur në ligjin për sektorin e energjisë elektrike, si dhe në politikat e Qeverisë për zhvillimin e këtij sektori.

Gjithashtu, Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike është hartuar në zbatim të direktivave të Bashkimit Europian për energjinë elektrike, si dhe të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë së vendeve të Europës Juglindore, për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, dokument ky i ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2006.

Struktura e mëparshme e quajtur Modeli Transitor i Tregut të Energjisë Elektrike gjatë procesit të zbatimit në praktikë, evidentoi nevojën e përditësimit të tij, në funksion të zhvillimeve që lidhen me thellimin e reformës në sektorin elektroenergjetik shqiptar të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare.

Struktura e re e quajtur Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, parashikon zhvillimin mbi baza më të konsoliduara të tregut të energjisë elektrike dhe përputhshmëri më të plotë me direktivat e Bashkimit Europian dhe parashikohet të ketë një qëndrueshmëri më të gjatë se faza transitore që parashikonte modeli i mëparshëm.

Modeli i Tregut i paraqitur merr në konsideratë:

- Hapat që ka ndërmarrë Qeveria nga struktura vertikalisht e integruar e sektorit elektroenergjetik, drejt ndarjes së veprimtarive në shoqëri gjenerimi, transmetimi dhe shpërndarjeje, ligjërisht, funksionalisht dhe financiarisht të ndara.
- Objektivin politik të Qeverisë për fillimin e procesit të privatizimit në sektorin elektroenergjetik shqiptar.
- Përshtatjen e legjislacionit të energjisë elektrike me atë të Bashkimit Europian.

- Zhvillimin e tregut të energjisë elektrike mbështetur në rregulla tregu dhe në kode të rrjetit të qarta, si kërkesa minimale teknike për një operim eficient të sistemit elektroenergjetik.

- Përfitime sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm.

- Vendosijen e aksesit për palët e treta, për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jodiskriminues të energjisë elektrike.

- Liberalizimin e tregut të energjisë elektrike duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të.

- Monitorimin e tregut të energjisë elektrike nga ERE, si një institucion i pavarur me autoritetin për të miratuar gjithë legjislacionin e nevojshëm sekondar për këtë qëllim.

- Hartimin e një protokolli pagesash ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, për të shmangur diskriminimet dhe devijimet e mundshme të fondeve.

- Zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e efikasitetit të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

- Integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit tonë në tregun rajonal e më vonë në tregun europian të energjisë elektrike.

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike mund të jetë objekt përditësimi në funksion të zhvillimeve që do të ketë sektori elektroenergjetik shqiptar dhe angazhimeve që vendi ynë mund të marrë në kuadrin e bashkëpunimit rajonal.

1. Qëllimi dhe objekti

1.1 Synimi i Modelit të Tregut

- Të krijojë kushte për të shkuar drejt një tregu të konsoliduar.
- Të sigurojë fluks fondesh dhe llogarish transparente dhe efikente.
- Të lejojë tregtim të energjisë elektrike, import dhe eksport, të orientuar nga tregu, duke ruajtur përfitimet për klientët.

1.2 Kërkesat që Modeli i Tregut të funksionojë në mënyrë efektive

- Të ekzistojnë llogari transparente për tregun e rregulluar, si dhe për operatorët e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes.

- Të ketë mbikëqyrje rregullatore nga ERE.

- Të ketë struktura të monitorimit të tregut dhe të raportimit të të dhënave.

- Rregullat e tregut dhe kodet përkatëse të jenë fleksibël dhe njëkohësisht të mbrojnë në mënyrë efektive nga çdo mundësi korrupsioni.

1.3 Synime të tjera me rëndësi të Modelit të Tregut

- Të marrë në konsideratë shndërrimin e KESH-it nga një shoqëri vertikalisht e integruar në një strukturë me entitete të ndara ligjërisht, financiarisht dhe funksionalisht.

- Të krijojë strukturën e nevojshme që konkurrenca të zhvillohet si në tregun e shitjes me shumicë, ashtu edhe për klientët e kualifikuar.

- Të krijojë strukturën e nevojshme ligjore dhe rregullatore për privatizimin e industrisë elektroenergjetike, duke filluar me sektorin e shpërndarjes.

- Të zbatojë politikën e qeverisë për të minimizuar rolin tregtar të OST-së dhe për të rritur transparencën.

2. Përcaktimet

Termet dhe shkurtimet e përdorura në këtë dokument kanë kuptimin e mëposhtëm:

- “Tregu i energjisë elektrike” është shkëmbimi i kërkesës dhe furnizimit për blerjen, shitjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

- “Modeli i tregut të energjisë elektrike” është një sistem që përcakton pjesëmarrësit në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

- “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, baza ligjore për ushtrimin e përgjegjësisë të të cilit përcaktohet nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- “Rregulla tregu” do të thotë tërësia e rregullave të miratuara nga ERE që përcaktojnë procedurat për operimin dhe menaxhimin e tregut, si dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

- “Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur i përbërë nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike të konsumatorët.

- “KESH” do të thotë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

- “OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit.

- “KESH-Gen” do të thotë një divizion i KESH-it për prodhimin e energjisë elektrike.

- “OSSH” do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që kryen funksionin e shpërndarjes dhe të furnizuesit publik.

- “Furnizuesi publik” është një strukturë e organizuar brenda OSSH-së, e ndarë funksionalisht dhe financiarisht, që kryen funksionin e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë.

- “PVE” do të thotë prodhues i vogël i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- “PPE” do të thotë prodhues i pavarur i energjisë elektrike i lidhur në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

- “Furnizues i kualifikuar” është një pjesëmarrës i tregut, i licencuar për të furnizuar me energji elektrike klientët e kualifikuar.

- “Tregtues” është person i licencuar që blen dhe shet energji elektrike me shumicë.

- “Klient tarifor” është një konsumator i energjisë elektrike që blen energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

- “Klient i kualifikuar” është konsumatori i energjisë elektrike që ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin, nga i cili blen energjinë elektrike për nevojat e veta.

- “AKBN” do të thotë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

- “Kontrata dypalëshe” janë marrëveshje që lidhin pjesëmarrës të ndryshëm të tregut në shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, si dhe shërbimeve ndihmëse.

- “Fluksi i fondeve” është shkëmbimi i vlerave monetare kundrejt shlyerjes së detyrimeve kontraktore ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

- “Fluksi i energjisë elektrike” është kapaciteti ose ngarkesa e energjisë elektrike që kalon nëpër sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

- “QKD” do të thotë Qendra Kombëtare Dispeçer.

3. Modeli i Tregut

3.1 Synimet dhe objektivat:

Modeli Shqiptar i Tregut është disenjuar që të çojë përpara politikat e Qeverisë Shqiptare në fushat e mëposhtme:

i) Në privatizimin e sektorit elektrik, duke krijuar një kuadër për privatizimin e funksioneve të shpërndarjes në një afat të shkurtër. Ky kuadër do të sigurojë një bazë të shëndoshë për privatizimin e segmenteve të tjerë të sektorit elektroenergjetik, si ai i gjenerimit.

ii) Në drejtim të përputhjes me direktivat e BE-së dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

iii) Në minimizimin e mundësive për korrupsion dhe për veprimtari ekonomike informale. Modeli i Tregut për këtë qëllim vendos një metodë të kontratave dypalëshe për blerjen e energjisë për të përmirësuar transparencën dhe për të shmangur “mbivendosjen” e transaksioneve pa qenë të nevojshme.

iv) Në ruajtjen e vlerës së plotë të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve hidro në favor të klientëve tariforë shqiptarë.

v) Në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik duke qartësuar përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe duke siguruar flukse të mjaftueshme të informacionit lidhur me operimin e tregut dhe duke krijuar një strukturë të qartë për transaksionet financiare.

vi) Në sigurimin e përfitimeve për klientët.

Këto synime dhe objektiva janë në përputhje dhe reflektojnë gjithashtu zhvillimin e mëtejshëm të synimeve dhe objektivave të parashtuara në seksionin A të Modelit Transitor të Tregut, që është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12 gusht 2004. Mbas miratimit nga Qeveria, Modeli Shqiptar i Tregut do të zëvendësojë Modelin Transitor të Tregut.

4. Pjesëmarrësit dhe karakteristikat e Modelit të Tregut

Modeli i Tregut trajton gjithashtu përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).

Modeli Shqiptar i Tregut, në kuptimin e gjerë, karakterizohet nga kontrata dypalëshe të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve të tregut nga njëra anë: KESH-Gen-i, PVE-të, PPE-të, furnizuesit e kualifikuar, dhe entiteteve që i shërbejnë ngarkesës dhe nga ana tjetër OSSH-ja dhe klientët e kualifikuar.

Tregtuesit janë subjekte që realizojnë blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë.

Shërbimet ndihmëse për sistemin e transmetimit blihen nga OST-ja.

Rregullimi i çmimeve, termave dhe kushteve të tjera në kuadrin e Modelit të Tregut është gjithpërfshirës. Ai reflekton situatën monopol në të ardhmen e afërt të KESH-Gen-it, OSSH-së dhe OST-së.

Të gjitha kontratat dhe tarifat ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut, do të jenë të rregulluara, që në pikënisjen e tyre, me përjashtim të:

a) Kontratave ndërmjet tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar nga njëra anë dhe OSSH-së dhe klientëve të kualifikuar, nga ana tjetër.

b) Kontratave ndërmjet PVE-ve, PPE-ve dhe klientëve të kualifikuar.

c) Kontratave ndërmjet KESH-Gen-it nga njëra anë dhe tregut të eksporteve ose klientëve të kualifikuar, nga ana tjetër, në masën që lejohet nga kufizimet e tjera ndaj shitjeve të KESH-Gen-it.

d) Kontratat ndërmjet PVE-ve, PPE-ve nga njëra anë dhe tregtarëve nga ana tjetër.

4.1 OST-ja

Është shoqëri e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:

- Operimin e rrjetit të transmetimit nga pikëpamja fizike (posedim, mirëmbajtje dhe zgjerim) (ORRT);

- Operatorin e sistemit nga pikëpamja e dispeçerimit (OS);

- Operatorin e tregut (duke siguruar që informacioni për likuidimin e kontratave është i disponueshëm, që më pas mund të shërbejë si një bursë e energjisë elektrike).

OST-ja verifikon:

Informacionin nëse OSSH/Furnizuesi publik i ka siguruar të gjitha burimet e mjaftueshme për të furnizuar klientët tarifarë, sipas grafikëve të ngarkesës vit, muaj, javë dhe ditë në avancë.

OST-ja ka autoritet:

T'i kërkojë OSSH/Furnizuesit publik që të bëjë blerje energjie në përputhje me nevojën për energji.

T'i kërkojë klientëve të kualifikuar të vërtetojnë se ata do të jenë në gjendje të sigurojnë furnizimin e mjaftueshëm për veten e tyre.

OST-ja ka të drejtë:

Të parashikojë dhe të blejë nga KESH-Gen-i, si dhe ofruesit e tjerë shërbime ndihmëse sipas nevojës vit, muaj, ditë në avancë dhe në kohë reale. Të kompensohet për shërbimet nga pjesëmarrësit që i përfitojnë ato, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

4.2 Gjenerimi (KESH-Gen)

I shet OSSH/Furnizuesit publik energji elektrike sipas kërkesave të saj me çmim të miratuar nga ERE.

Shitja bëhet sipas marrëveshjeve vjetore ose për periudha të tjera siç miratohen nga ERE.

I shet OSSH/Furnizuesit publik energji elektrike shtesë për të plotësuar kërkesat e klientëve tarifarë me çmim të miratuar nga ERE.

Shet energji të tepërt në tregun e eksportit në përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE.

Përfitimet nga shitblerja e energjisë elektrike i reflektohen OSSH-së në favor të klientëve tariforë.

Shkëmben energji elektrike në tregun e eksportit në përputhje me rregullat e procedurat e shkëmbimit të miratuara nga ERE.

Të gjitha përfitimet nga kapaciteti hidro vendas ruhen për klientët tariforë shqiptarë.

ERE monitoron që ky proces i shitjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike të bëhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE për shitjen dhe shkëmbimet e energjisë elektrike.

4.3 Prodhuesit e vegjël të energjie elektrike (PVE)

Prodhues të vegjël janë hidrocentralet e vegjël, vetëprodhuesit dhe kogjeneruesit e vegjël që lidhen në sistemin e shpërndarjes.

PVE-të licencohen për të shitur energji elektrike me çmime të rregulluara te OSSH/Furnizuesi publik ose në tregun e eksportit, te klientët e kualifikuar, furnizuesit e kualifikuar ose tregtuesit me terma komerciale të rëna dakord ose të miratuara nga ERE, nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje.

ERE përcakton një tarifë të thjeshtë e të njehsuar të shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et e vegjël në tregun e rregulluar.

4.4 Prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike (PPE)

PPE-të janë prodhuesit e pavarur që lidhen direkt në sistemin e transmetimit.

PPE-të licencohen nga ERE dhe mund t'u shesin kapacitete ose energji tregut të eksportit, klientëve të kualifikuar, furnizuesve të kualifikuar, tregtarëve me çmime tregu ose OSSH/Furnizuesit publik me çmim kontrate të miratuar nga ERE.

4.5 Furnizuesit e kualifikuar (FK)

Furnizues të kualifikuar janë:

Furnizuesit vendas ose të huaj të licencuar nga ERE, të cilët mund të blejnë energji nga jashtë, nga PVE-të ose nga PPE-të për t'ua shitur klientëve të kualifikuar.

PVE-të dhe PPE-të duhet të licencohen që të bëhen furnizues të kualifikuar, nëse ata vendosin që t'i shesin direkt energji elektrike klientëve të kualifikuar.

4.6 Tregtuesit

Janë subjekte private vendase ose të huaja, që blejnë dhe shesin energji elektrike me shumicë.

Tregtuesit licencohen nga ERE.

Tregtuesit mund të blejnë energji nga PVE-të dhe PPE-të, për t'ia shitur OSSH/Furnizuesit publik.

PPE-të ose PVE-të kur i shesin energji elektrike vetëm OSSH/Furnizuesit publik pajisen vetëm me licencë prodhimi.

PPE-të, PVE-të ose furnizuesit e kualifikuar duhet të kenë licencë tregtimi që të jenë tregtues, d.m.th. që të kryejnë transaksione me shumicë të energjisë elektrike.

ERE do të sigurojë që licencat dhe procedurat e licencimit për tregtuesit janë të thjeshta, jodiskriminuese dhe nuk krijojnë pengesa të panevojshme për hyrjen e tregtuesve në tregun shqiptar. Kërkesat e licencimit do të kufizohen në kërkesën që tregtuesit t'i sigurojnë ERE-s informacion lidhur me veten dhe veprimtaritë e tyre dhe se tregtuesit zbatojnë të gjitha rregullat e aplikueshme të tregut.

4.7 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

OSSH-ja zotëron, mirëmban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë.

OSSH/Furnizuesi publik ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike për furnizimin pa ndërprerje të klientëve tariforë.

OSSH/Furnizuesi publik ka përgjegjësinë që të shërbejë si sigures i alternativës së fundit për të gjithë klientët.

OSSH-ja u siguron shërbim lidhjeje dhe shpërndarjeje PVE-ve dhe klientëve të kualifikuar mbi baza jodiskriminuese.

Tarifat e shitjes së energjisë elektrike për klientët tariforë dhe të shërbimit të shpërndarjes, për të gjithë përdoruesit e tjerë të sistemit të shpërndarjes, termat dhe kushtet e shërbimeve të shpërndarjes që sigurohen nga OSSH/Furnizuesi publik rregullohen nga ERE.

OSSH/Furnizuesi publik ka përgjegjësinë t'i sigurojë OST-së grafikët e ngarkesës vjetore, mujore, javore dhe ditore në avancë.

OSSH/Furnizuesi publik ka përgjegjësinë t'i vërtetojë OST-së se ka siguruar furnizim të mjaftueshëm me energji për të plotësuar kërkesën.

OSSH/Furnizuesi publik blen nga KESH-Gen-i të gjithë energjinë elektrike të prodhuar prej tij nga burimet hidro dhe burimet e tjera gjeneruese, si dhe energji tjetër për aq sa i nevojitet për të plotësuar kërkesën e klientëve të saj tariforë.

OSSH/Furnizuesi publik i shet energji elektrike me tarifa të rregulluara nga ERE vetëm klientëve tariforë.

Kontrata ndërmjet KESH-Gen-it dhe OSSH/Furnizuesit publik duhet të reflektojë optimizimin e duhur të sistemit të KESH-Gen-it.

OSSH/Furnizuesi publik ka të drejtë të mbulojë nga klientët fundorë nëpërmjet tarifave, të gjitha kostot e arsyeshme të realizuara për blerjen e energjisë, përfshirë koston e energjisë elektrike të importuar, si dhe kostot e blerjeve nga KESH-Gen-i dhe furnizuesit e tjerë.

OSSH/Furnizuesit publik do t'i kërkohet të sigurojë të gjitha furnizimet e disponueshme, përfshirë importet, për të shmangur kufizimin e ngarkesës. OSSH/Furnizuesi publik, me miratimin e ERE-s, mund të refuzojë blerjen e furnizimeve, kur kostoja e furnizimit kalon vlerën e koston së mosfurnizimit të përcaktuar nga ERE, në përputhje me politikën e Qeverisë dhe në konsultim me Këshillin e Ministrave.

4.8 Klientët tariforë

Klientë tariforë janë ata klientë që blejnë energji elektrike nga OSSH/Furnizuesi publik me tarifa të rregulluara nga ERE.

4.9 Klientët e kualifikuar

Janë klientë që mund të blejnë energji elektrike nga PVE-të, PPE-të dhe furnizuesit e kualifikuar sipas ligjit dhe procedurave të miratuara nga ERE.

Çdo klient është i lirë të zgjedhë të mbetet klient tarifor apo të bëhet i kualifikuar, nëse plotëson kushtet përkatëse.

ERE harton rregulla për të përcaktuar kushtet në të cilat një klient mund të kthehet në kategorinë e klientëve tariforë, pasi ka zgjedhur të bëhet klient i kualifikuar.

4.10 Rregullatori i pavarur (ERE)

ERE është përgjegjëse:

a) për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive të pjesëmarrësve të tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jodiskriminuese që sigurojnë aksesin e palëve të treta;

b) për të siguruar kontroll rregullator për tregun e energjisë elektrike;

c) në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike (neni 25), ERE do t'u kërkojë të licencuarve të veprojnë në një mënyrë të tillë që të sigurojnë sigurinë e furnizimit afatshkurtër dhe afatgjatë. Në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike (neni 24), ERE mund t'u kërkojë OSSH/Furnizuesit publik një program investimesh ose ekzekutimin e marrëveshjeve të blerjes së energjisë elektrike, përderisa këto kërkesa janë në përputhje me strategjinë kombëtare të hartuar nga Këshilli i Ministrave dhe çdo marrëveshje privatizimi.

Baza ligjore për ushtrimin e këtyre përgjegjësisë nga ERE sigurohet nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

4.11 Marrëdhëniet mes pjesëmarrësve të tregut

Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në operimin fizik të Modelit të Tregut bazohet në kontrata dypalëshe mes pjesëmarrësve të ndryshëm, në përputhje me përcaktimet e mëposhtme:

A. Tregu i rregulluar

1. Ndërmjet KESH-Gen-it dhe OSSH/Furnizuesit publik;

2. Ndërmjet OST-së dhe pjesëtarëve të tjerë të tregut për transmetimin dhe shërbimet që lidhen me të;

3. Ndërmjet OSSH-së dhe pjesëtarëve të tjerë të tregut për shpërndarjen dhe shërbimet që lidhen me të;

4. Ndërmjet PVE-ve/PPE-ve dhe OSSH/Furnizuesit publik;

5. Ndërmjet OSSH/Furnizuesit publik dhe klientëve të saj tariforë;

6. Ndërmjet KESH-Gen-it dhe kontratave të importit;

7. Ndërmjet OST-së dhe KESH-Gen-it, PVE-ve, PPE-ve dhe tregtuesve, për humbjet e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse.

B. Tregu i hapur

8. Ndërmjet furnizuesve të kualifikuar dhe klientëve të kualifikuar;

9. Ndërmjet PVE-ve/PPE-ve dhe klientëve të kualifikuar;

10. Nëpërmjet PVE-ve/PPE-ve, furnizuesve të kualifikuar dhe tregtuesve.

Të gjitha marrëdhëniet e mësipërme bazohen në marrëveshje tip të miratuara nga ERE, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë pjesëmarrësit.

Marrëdhëniet e ndryshme kontraktuale ndërmjet OST-së, KESH Gen-i, OSSH/Furnizuesit publik, klientëve tariforë, klientëve të kualifikuar, PVE-ve, PPE-ve, tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar paraqiten në shtojcat C dhe D.

Shtojca B paraqet flukset e energjisë elektrike ndërmjet subjekteve të ndryshme.

5. Karakteristikat esenciale të Modelit të Tregut

5.1 Parashikimi afatgjatë

OST-ja ka për detyrë të përgatisë parashikime 15-vjeçare për nevojat e vendit për energji elektrike.

Këtë parashikim OST-ja e mbështet mbi parashikimet e pjesëtarëve të tregut:

- OSSH/Furnizuesi publik;

- KESH-Gen-i;

- Si dhe parashikimet e bëra nga AKBN-ja ose agjenci të tjera shtetërore të specializuara.

Pjesëmarrësit e tjerë të tregut si furnizuesit e kualifikuar dhe klientët e kualifikuar janë të detyruar t'i paraqesin OST-së parashikimet e tyre vjetore dhe informacionin mbështetës për energjinë elektrike.

OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar nga pjesëtarët e tregut në ato raste kur nxjerrja e tij dëmton konkurrencën.

Për përmbushjen e detyrimit të saj të parashikimit, OST-ja krijon një departament të veçantë parashikimi me ekspertizën e nevojshme.

5.2 Kontrata e furnizimit të një viti në avancë

i) Shërbime ndihmëse:

OST-ja blen nëpërmjet kontratës së shërbimeve ndihmëse, shërbimet që i nevojiten sistemit në përputhje me parashikimet që i dërgohen asaj nga OSSH/Furnizuesi publik dhe klientët e kualifikuar.

KESH-Gen-i i ofron OST-së për të shitur shërbime ndihmëse sipas marrëveshjes vjetore të shërbimeve ndihmëse që negociohet midis tyre dhe miratohet nga ERE.

Shërbimet ndihmëse përfshijnë edhe energjinë balancuese.

OST-ja blen shërbime ndihmëse shtesë në rast se këto shërbime nuk ia sigurojnë kontratat e lidhura.

Shërbimet ndihmëse shtesë, OST-ja mund t'i blejë nga KESH-Gen-i dhe nga PPE-të, tregtuesit ose furnizuesit e kualifikuar për aq sa është e mundshme.

b) Energji elektrike:

KESH-Gen-i, pasi merr në konsideratë kontratën për shërbimet ndihmëse, i ofron OSSH/Furnizuesit publik energji elektrike në atë sasi dhe kapacitet që kërkon, me çmime dhe kushtet të rregulluara.

Çmimi i energjisë dhe termat e livrimit miratohen nga ERE.

Kur energjia, që OSSH/Furnizuesi publik ka blerë sipas kontratave nga KESH-Gen-i, nuk është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat me energji elektrike të OSSH/Furnizuesit publik, kjo e fundit mund të blejë energji shtesë nga KESH-Gen-i, PVE-të, PPE-të ose tregtuesit.

c) Muaji në avancë

Jo më vonë se 10 ditë para një muaji të caktuar në vitin në avancë, QKD-ja do të hartojë një plan mujor operimi për operimin e sistemit elektroenergjetik të bazuar në informacionet mujore të siguruar nga pjesëmarrësit e tregut.

Plani mujor i operimit për muajin në avancë do të përmbajë:

- kërkesën për energji elektrike dhe mbulimin nga prodhimi vendas;
- energjinë e importuar të programuar;
- grafikët tip të ngarkesës javore dhe ditore gjatë muajit për ditët e punës, për ditët e shtuna e të diela dhe për ditët e festave, si dhe grafiku tip mujor i ngarkesës;
- verifikimin e nivelit të liqenit të Fierzës;
- planin mujor të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera të programuara të gjeneratorëve;
- planin mujor për shërbime ndihmëse;
- vlerësimin e operimeve të parashikuara në terma të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së sistemit elektroenergjetik dhe masat e parashikuara gjatë muajit për të ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë sipas nevojës;
- për të ndihmuar OST-në në përgatitjen e planit mujor të operimit, pjesëmarrësit e tregut (KESH-Gen-i, OSSH/Furnizuesi publik, klientët e kualifikuar, furnizuesit e kualifikuar, tregtuesit, PPE-të etj.), do t'i japin OST-së informacionin e kërkuar të specifikuar, jo më vonë se 20 ditë para fillimit të muajit për të cilin është përgatitur plani.

5.4 Java në avancë

Përpara çdo jave operimi, OSSH/Furnizuesi publik duhet të përgatisë parashikimin ditor të ngarkesës për javën e ardhshme duke e përditësuar atë me OST-në. Përpara çdo jave operimi, OSSH/Furnizuesi publik bazuar në kontratat dypalëshe përcakton sasinë e nevojshme të energjisë elektrike që ajo do të kërkojë nga KESH-Gen-i për të mbuluar ngarkesën javore.

OSSH/Furnizuesi publik do të mbulojë mungesat e furnizimit të energjisë elektrike nga PVE-të, PPE-të, tregtuesit ose furnizuesit e kualifikuar.

5.5 Dita në avancë dhe axhustimet ditore

OSSH/Furnizuesi publik mund të rishikojë projeksionet e tij të parashikimit të ngarkesës kur nga përditësimi i ngarkesës së parashikuar janë të qarta diferencat ndërmjet energjisë së parashikuar dhe të asaj të kërkuar. OSSH/Furnizuesi publik gjatë modifikimit të parashikimit të ngarkesës mund të blejë energji elektrike, jashtë kontratës, nga KESH-Gen-i me çmime të rregulluara, nga PVE-të që kanë kontratë me OSSH/Furnizuesin publik me tarifa të përcaktuara nga ERE, si dhe nga PVE-të e tjera, PPE-të dhe tregtuesit me çmime të parregulluara.

Në rast se parashikimet e përditësuara të ditës në avancë tregojnë se kërkohet energji elektrike shtesë nga ajo që mund të sigurohet nga të gjitha burimet e disponueshme, përfshirë PVE-të, PPE-të, tregtuesit dhe furnizuesit e kualifikuar, OST-ja mund t'i kërkojë OSSH/Furnizuesit publik të vendosë procedura të kufizimit të ngarkesës për të mbajtur sistemin e transmetimit të balancuar. Në rast se parashikimet e përditësuara të ditës në avancë tregojnë se kërkohet më pak energji sesa ajo që është parashikuar, OSSH/Furnizuesi publik axhuston parashikimin e ngarkesës së ditës në avancë duke ulur furnizimin nga PVE-të, PPE-të ose tregtuesit.

5.6 Procedurat tipike që ndiqen nga OST-ja

OST-ja ka përgjegjësinë të dispeçerohet të gjitha njësitë në zotërim të KESH-Gen-it, të PPE-ve, tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar dhe të respektojë të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara në rregullat e tregut për:

- a) ditën e operimit;
- b) ditën pas ditës së operimit;
- c) ditën e pestë pas ditës së operimit;
- d) axhustimet e një dite në avancë dhe brenda ditës

OST-ja do të vendosë, me miratimin e ERE-s, procedura operimi që përcaktojnë afate kohore ("*gate closure*") për nominimin (përcaktimin) fizik dhe rregulla të tjera që i kërkojnë OST-së për të kryer funksionet e saj të dispeçerimit dhe balancimit.

OST-ja do të krahasojë shumën e parashikimeve të ngarkesës së marrë nga pjesëtarët e tregut me parashikimet e saj dhe të vendosë se çfarë hapash të mëtejshëm (p.sh. blerje) mund të jenë të nevojshme për të balancuar sistemin.

ERE ka përgjegjësinë, që rregullat e tregut të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet operative që duhet të kryejë OST-ja për dispeçerimin dhe të veprimtarive të tjera të përfshira në sistemin elektroenergjetik.

5.7 Shitjet e KESH-Gen-it të blerës të tjerë

Marrëveshjet e furnizimit ndërmjet KESH-Gen-it dhe OSSH/Furnizuesit publik do të sigurojnë që përfitimet nga kapacitetet hidro të KESH-Gen-it të jenë për klientët tariforë shqiptarë. Megjithatë, KESH-Gen-i me miratimin e ERE-s mund të shesë çdo kapacitet të tij mbi sasinë e kontraktuar me OSSH/Furnizuesin publik me çmime të parregulluara.

KESH-Gen-i mund të shesë energjinë elektrike të prodhuar prej tij në tregun me çmime të parregulluara duke siguruar blerje ekonomike në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga ERE për shitjen e energjisë elektrike, si dhe në përputhje me ligjin për importin e energjisë elektrike.

KESH-Gen-i mund të kryejë procedurat e shitjes së energjisë elektrike me kusht që:

1. Të ketë marrë një licencë eksporti të energjisë elektrike nga ERE për të shitur energji elektrike.

2. Termat e kësaj shitjeje, të përcaktuara nga ERE në rregullat dhe procedurat e shitjes nuk do të reduktojnë përfitimet e përgjithshme të klientëve tariforë dhe nuk do të pengojnë përmbushjen e detyrimeve të KESH-Gen-it sipas kontratave të tij me OSSH/Furnizuesin publik.

KESH-Gen-i do të mbajë riskun tregtar dhe të kreditimit si pasojë e këtyre shitjeve dhe të plotësimit të detyrimit të vazhdueshëm për furnizimin me energji elektrike të OSSH/Furnizuesit publik.

Çdo fitim neto nga shitjet ose shkëmbimet e energjisë elektrike të bëra nga KESH-Gen-i, nëse do të ketë, do të reflektohet në përfitim të klientëve tariforë.

ERE merr në konsideratë dhe adapton mekanizma nxitëse që do të vlerësohen të përshtatshme nga ERE, përfshirë edhe lejimin e KESH-Gen-it për të mbajtur një pjesë të fitimit neto nga eksporti.

6. Fluksi i fondeve

Fluksi i fondeve në modelin e tregut tregohet në shtojcën E.

Fluksi i fondeve për pjesëmarrësit kryesorë të tregut është përmbledhur si më poshtë:

6.1 OST-ja

Të pagueshme:

OST-ja do t'i paguajë KESH-Gen-it, PPE-ve, tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar për shërbimet ndihmëse të blera prej saj.

Të arkëtueshme:

a) Klientët e kualifikuar, KESH-Gen-i, PPE-të, PVE-të, tregtuesit, furnizuesit e kualifikuar dhe OSSH/Furnizuesi publik do t'i paguajnë OST-së pagesat e transmetimit (për aq sa aplikohet) të llogaritura në përputhje me tarifën që përfshihet në Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të miratuar nga ERE;

b) si dhe pagesat për tarifën e alokimit të kapaciteteve.

6.2 KESH-Gen-i

Të pagueshme:

KESH-Gen-i do t'i paguajë OST-së (për aq sa aplikohet) për shërbimin e transmetimit të siguruar sipas tarifave të miratuara nga ERE;

KESH-Gen-i do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar për blerjet e energjisë ekonomike (që do të thotë energji që mund të jetë e disponueshme në kohë të caktuara të ditës ose vitit e që mund të blihet më lirë nga sa mund ta prodhonte KESH-Gen-i dhe që mund të përdoret ekonomikisht për nevojat e centralit ose për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale).

Të arkëtueshme:

OSSH/Furnizuesi publik do t'i paguajë KESH-Gen-it për energjinë elektrike me tarifa të rregulluara;

OST-ja do t'i paguajë KESH-Gen-it për shërbimet ndihmëse;

Partnerët e eksportit, klientët e kualifikuar, tregtuesit dhe furnizuesit e kualifikuar do t'i paguajnë KESH-Gen-it për energjinë elektrike për aq sa do të lejohet shitja e kësaj energjie.

6.3 Operatori ose Shoqëria e Sistemit të Shpërndarjes/Furnizuesi publik

Të Pagueshme:

OSSH/Furnizuesi publik do t'i paguajë KESH-Gen-it për të gjithë energjinë elektrike me të cilën ajo ka furnizuar OSSH/Furnizuesin publik për klientët tariforë.

Humbjet në sistemin e transmetimit për shitjet e KESH-Gen-it i përkasin OST-së.

OSSH/Furnizuesi publik do t'i paguajë PVE-ve, PPE-ve, tregtuesve dhe furnizuesve të kualifikuar për energjinë elektrike që i kanë furnizuar OSSH/Furnizuesit publik.

OSSH/Furnizuesi publik do t'i paguajë OST-së pagesat për shërbimin e transmetimit, përfshirë koston e shërbimeve ndihmëse, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

Të arkëtueshme:

Klientët tariforë do t'i paguajnë OSSH/Furnizuesit publik për energjinë elektrike që u është livruar sipas tarifave të miratuara nga ERE.

Klientët tariforë dhe klientët e kualifikuar do t'i paguajnë OSSH-së shërbimet e rrjetit për energjinë elektrike që u livrohet atyre sipas tarifave të miratuara nga ERE.

Fluksi i fondeve që përfshin këta dhe pjesëmarrës të tjerë të tregut janë dhënë në shtojcën E.

7. Operimet e shpërndarjes

OSSH/Furnizuesi publik i propozon ERE-s tarifën e shërbimeve të furnizimit dhe shpërndarjes në mënyrë që çdo klient tarifor brenda të njëjtës klasë klientësh në të gjithë vendin të paguajë të njëjtën tarifë të njehsuar.

OSSH-ja i siguron shërbimin e shpërndarjes klientëve të kualifikuar sipas tarifave të përdorimit të sistemit të shpërndarjes të miratuara nga ERE.

OSSH-ja do të përdorë të njëjtën metodologji për të llogaritur tarifën e përdorimit të sistemit të shpërndarjes, që ajo përdor për llogaritjen e tarifave për klientët tariforë.

OSSH/Furnizuesi publik do t'ia propozojë të ndarë ERE-s tarifën e shërbimit të shpërndarjes nga tarifën e furnizimit të klientëve tariforë.

8. Roli i rregullatorit të pavarur ERE

ERE e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me të gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit të pavarur përmbush kërkesat e direktivës së BE-së 2003/54 dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. ERE i rekomandon Qeverisë Shqiptare modelin e tregut të energjisë elektrike dhe miraton të gjitha aktet nënligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pas miratimit të Modelit të Tregut nga Qeveria Shqiptare, ERE do të procedojë me reflektimin e ndryshimeve në rregullat e tregut, dhe në aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionimin e tregut.

Në përgatitjen e këtyre dokumenteve ERE do të marrë në konsideratë:

a) Marrëdhëniet mes klientit të kualifikuar (KK) dhe OSSH-së. Këto marrëdhënie duhen trajtuar në mënyrë specifike në rregullat e tregut, që do të miratohen nga ERE duke marrë parasysh që:

- Një klient i kualifikuar nuk mund të jetë njëkohësisht dhe klient tarifor;
- një klient i kualifikuar nuk lejohet të blejë energji elektrike nga KESH-Gen-i (përveçse për aq sa lejohet në mënyrë specifike nga ERE) ose OSSH/Furnizuesi publik;
- rregullat e tregut duhet të përcaktojnë qartë rrethanat dhe pagesat për rikthimin e një klienti të kualifikuar si klient tarifor në mënyrë që të mbrojnë klientët tariforë nga rritja e kostove të shkaktuara nga ky rikthim.

b) Prioriteti në sistemin e transmetimit ose të menaxhimit të bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t'i përballojnë të gjitha kërkesat e klientëve tariforë dhe atyre të kualifikuar. Një çështje tjetër që duhet trajtuar në Kodin e Transmetimit dhe rregullat e

tregut është ajo se si do të ndahet mungesa e kapaciteteve mes klientëve tariforë dhe klientëve të kualifikuar në mënyrë që të implementohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jodiskriminues, me qëllim që të plotësojnë kërkesat e BE-së për akses të hapur dhe të përputhen me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Në hartimin e këtyre rregullave, duhet kërkuar kontributi i gjitha palëve të interesuara.

c) Tepricat e energjisë elektrike në disa periudha nga konsumatorët që prodhojnë energji për plotësimin, tërësisht ose pjesërisht, të kërkesave të tyre për energji elektrike, të cilat do të jenë të lidhura me sistemin, trajtohen si më poshtë:

Në rastet kur ekziston kapaciteti i mjaftueshëm dispeçerues, rregullat e tregut dhe Kodi i Transmetimit mund të sigurojnë akses në rrjet për këtë tepricë dhe ERE mund të përcaktojë tarifa për blerjen e kësaj energjie që krijon përfitim për konsumatorët.

ERE gjithashtu mund të përcaktojë pagesa përkatëse për kapacitet për të mënjanuar që një klient i tillë të lejohet të shkaktojë kosto mbi klientët tariforë. Nëse vetëprodhuesi është në pjesën më të madhe të kohës “jashtë sistemit”, por dëshiron ta përdorë sistemin si rezervë të njësisë vetëprodhuese në rast të mirëmbajtjes ose defektit, rregullat e tregut mund të specifikojnë një tarifë “*stand by*”, e cila duhet të miratohet nga ERE.

d) Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE dhe, në shumë raste OST-ja, duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve. Për këtë arsye, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve ERE duhet të sigurojë që të gjithë pjesëmarrësve të tregut do t’u kërkohej të japin të gjithë informacionin që kërkohej për kryerjen me sukses të funksioneve të ERE-s dhe OST-së, në mënyrë periodike, të plotë dhe të saktë, me kushtin e mbrojtjes së duhur nga nxjerrja e informacionit të ndjeshëm nga pikëpamja e konkurrencës. Ky informacion duhet të përfshijë të paktën disponibilitetin e njësisë gjeneruese dhe përdorimin aktual, disponibilitetin e transmetimit dhe përdorimin aktual, si dhe të dhëna të tjera lidhur me prodhimin dhe çmimet. Informacioni duhet të publikohet në faqet elektronike të ERE-s dhe OST-së, për aq sa ai do të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të konfidencialitetit.

e) Për aq sa e lejojnë rrethanat, ERE-ja duhet të rrisë efektivitetin e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjetik nëpërmjet aplikimit të një sistemi tarifor të energjisë elektrike për klientët tariforë, e cila nxit përdorimin e energjisë elektrike natën, dekurajon përdorimin e energjisë elektrike në orët e pikut, dhe inkurajon klientët tariforë për zvogëlimin e kapacitetit.

f) ERE miraton kontratat e negociuara nga palët, ku ndër të tjera do të përfshihen kontratat e mëposhtme:

- Kontrata njëvjeçare ndërmjet OSSH-së, në rolin e saj si furnizues publik ose “FP”, dhe KESH-Gen-it për energjinë neto, përfshirë çmimin, për orë dhe sezon, për çdo njësi përkatëse gjeneruese. Kontratat mund të specifikojnë gjithashtu energjinë dhe kapacitetin neto vjetor që do të jetë i sigurt (“*must-run*”).

- Kontratat dypalëshe afatgjata ndërmjet OSSH/Furnizuesit publik dhe çdo PPE-je për energjinë dhe kapacitetin neto, përfshirë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Kontratat dypalëshe afatgjata (njëvjeçare ose më shumë) ndërmjet OSSH/Furnizuesit publik dhe çdo PVE-je (gjeneruesit e shpërndarë) për energjinë dhe kapacitetin neto, të cilat mund të përfshijnë çmimin për çdo orë dhe sezon.

- Kontrata njëvjeçare ndërmjet OST-së dhe KESH-Gen-it për shërbimet ndihmëse.

g) ERE miraton modele kontratash për një numër kontratash ndërmjet pjesëmarrësve të tregut përfshirë:

- Kontratat dypalëshe për shërbimin e shpërndarjes ndërmjet OSSH-së dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes;

- Kontratat e shërbimit të transmetimit midis OST-së dhe përdoruesve të sistemit të transmetimit.

h) Shërbimi i disbalancës së energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale. Ai përfshin devijimet nga programet e transaksioneve dypalëshe. Ai mbulon gjithashtu flukset e paparashikuara të energjisë në sistem (për shembull nga sistemet jashtë

Shqipërisë). Përderisa klientët e transmetimit nuk e zgjidhin çështjen e disbalancimit nëpërmjet blerjeve të tyre, OST-ja do të bëjë blerjet e nevojshme për të siguruar që sistemi të mbetet i balancuar.

Disbalanca e gjenerimit është diferenca ndërmjet sasisë së energjisë elektrike të programuar për çdo orë, dhe sasisë së energjisë elektrike të dhënë nga një burim gjenerues.

Shërbimi i disbalancës së gjenerimit merret kur ka një diferencë ndërmjet energjisë së programuar dhe asaj aktuale të livruar nga një burim gjenerues.

Në përcaktimin e tarifave për shërbimet e energjisë balancuese (si pjesë e sigurimit të shërbimeve ndihmëse), OST-ja do të sigurojë që njësitë që krijojnë disbalancën vlerësohen me koston e plotë të korrektimit të disbalancës (përfshirë koston e energjisë së blerë nga OST-ja për të balancuar sistemin). Këto tarifa do të jenë jodiskriminuese dhe të bazuara në kosto. OST-ja, gjithashtu mund të vendosë me miratimin e ERE-s pagesa shtesë nëpërmjet ndëshkimeve për devijime të përsëritura të konsiderueshme nga parashikimet. Çdo e ardhur e tepërt e mbledhur nga OST-ja, nga të ardhurat e kërkuara për të paguar detyrimet e shërbimeve ndihmëse të saj, duhet t'u kthehen në fund të çdo muaji pjesëtarëve të tregut në mënyrë proporcionale.

i) Përmbushja e plotë nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të detyrimeve të tyre kontraktuale dhe të tarifave, përfshirë pagesën e plotë për energji dhe shërbime të tjera, është e rëndësishme për suksesin e Modelit Shqiptar të Tregut. Megjithatë, mund të ketë raste, veçanërisht gjatë kohës që tregu maturohet, kur nuk do të bëhet pagesa e plotë. ERE, në bashkëpunim me OST-në dhe pjesëtarët e tregut, duhet të përgatisë rregulla dhe kontrata model që rregullojnë çështjen e mospagesave apo pagesat e pjesshme. Ndër të tjera, ERE duhet të hartojë rregulla dhe procedura për të siguruar që autoriteti i saj rregullues ndaj OSSH/Furnizuesit publik të ushtrohet sipas protokollit të likuidimeve dhe të ketë mundësinë të ndjekë fluksin e fondeve brenda OSSH/Furnizuesit publik.

9. Marrëveshjet për blerjen e energjisë elektrike

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private për ndërtimin e centraleve të rinj elektrik për të plotësuar kërkesat e vendit me energji elektrike dhe për të garantuar siguri të lartë furnizimi nëpërmjet diversifikimit të burimeve të gjenerimit.

ERE ka autoritetin të kufizojë zgjatjen e afatit të kontratave afatgjata ndërmjet OSSH/Furnizuesit publik dhe PPE-ve apo furnizuesve të tjerë për të shmangur efektet bllokuese në zhvillimin e tregut për shkak të këtyre kontratave.

Kontratat afatgjata që kanë të bëjnë me luhatjet në çmimet e lëndës djegëse dhe në këmbimin valutor, duhen kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur.

Për të maksimizuar investimet private në vend dhe për të zvogëluar efektet përjashtuese në treg, rekomandohet që OSSH/Furnizuesi publik të blejë nga PPE-të vetëm një pjesë të prodhimit të tyre, ndërsa pjesa tjetër të lihet e lirë për t'u tregtuar me çmime të parregulluara brenda ose jashtë vendit.

10. Procesi i likuidimeve

Detajet e procesit të likuidimeve do të specifikohen në protokollin e likuidimeve, si pjesë e rregullave të tregut të miratuara nga ERE. Fondet e likuidimit duhet të përdoren sipas destinacionit për të shmangur devijimet e tyre. Procesi duhet planifikuar që të funksionojë në mënyrë transparente, të mirëpresë përdorimin e kontratave dypalëshe dhe të lehtësojë përmirësimin e nivelit të arkëtimeve.

ERE ka autoritet të plotë të sigurojë që veprimtaritë e palëve janë kryer sipas rregullave dhe protokollove dhe se këto transaksione financiare janë plotësisht transparente dhe të auditueshme.

Modeli i tregut reflekton përpjekjet për të minimizuar riskun e paafetësisë financiare, duke i dhënë në këtë mënyrë shitësit në treg siguri të lartë për pagesat. Lidhjet kontraktuale mes OST-së, OSSH/Furnizuesit publik dhe shitësve të energjisë elektrike janë përcaktuar qartë.

OSSH/Furnizuesi publik do të kompensojë OST-në vetëm për shërbimet e kryera prej saj dhe do të paguajë direkt shitësin (mund të jetë KESH-Gen-i, PPE-të, furnizuesit e kualifikuar etj.) për kostot e energjisë elektrike në përputhje me deklaratat (pasqyrat) e dërguara nga OST-ja tek OSSH/Furnizuesi publik.

Për të rritur besimin e shitësit që pagesat do të kryhen, duhet që:

- a) pagesat të bëhen direkt nga OSSH/Furnizuesi publik, e cila është më afër burimit të fondeve sesa shitësi;
- b) të mos lejohet transferimi i parave cash nga OSSH/Furnizuesi publik te OST-ja, me qëllim pagimin e shitësve të tjerë;
- c) kontratat dhe modelet e kontratave miratohet nga ERE.

SHTOJCA A SHËRBIMET NDIHMËSE

Shërbimet ndihmëse trajtohen në Kodin e Transmetimit dhe shërbejnë për të mbështetur transmetimin e kapaciteteve dhe të energjisë nga burimet te ngarkesa duke mbajtur operime të sigurt të sistemit të transmetimit.

Shërbimet ndihmëse përfshijnë:

- Programimin, kontrollin e sistemit elektroenergjetik dhe dispeçerimin e tij;
- Furnizimin me energji elektrike reaktive dhe kontrollin e tensionit nga burimet gjeneruese;
- Rregullimin dhe ristabilizimin e frekuencës;
- Rezervën operuese – shtesë;
- Rezerva operuese – Shërbimi i rezervës rrotulluese.

Shërbimi i programimit, kontrollit të sistemit dhe dispeçerimit është i nevojshëm për të siguruar optimizimin e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjetik.

Furnizimi me energji elektrike reaktive dhe kontrolli i tensionit nga shërbimi i burimeve gjeneruese është i nevojshëm që të mbajë nivelet e tensionit në pajisjet e transmetimit brenda kufijve të pranueshëm. OST-ja është përgjegjëse për të ruajtur nivelet e tensionit brenda kufijve të lejuar.

Shërbimi i rregullimit dhe ristabilizimit të frekuencës është i nevojshëm për të siguruar balancim të vazhdueshëm të burimeve (gjenerim dhe shkëmbim) me ngarkesën dhe për të mbajtur frekuencën e programuar të interkoneksionit në 50 Hz. Shërbimi i rregullimit dhe ristabilizimit të frekuencës realizohet nëpërmjet: a) Rezervës rrotulluese; b) Rezervës shtesë; c) Ndarjes së frekuencës.

Rezerva operuese – Shërbimi i rezervës shtesë është i nevojshëm për t'i shërbyer ngarkesës në rast të ndonjë ngjarjeje të paparashikuar në sistem. Megjithatë, ajo nuk është e disponueshme menjëherë për t'i shërbyer ngarkesës, por brenda një periudhe kohe të shkurtër. Shërbimin e rezervës shtesë mund ta sigurojnë njësitë gjeneruese që janë në linjë (on-line), por të pangarkuara, gjeneruesit që startojnë shpejt ose ngarkesat që mund të ndërpriten. Madhësia e rezervës operuese shtesë përcaktohet në Kodin e Transmetimit. OST-ja është përgjegjëse për sigurimin e këtij shërbimi.

Rezerva operuese – Shërbimi i rezervës rrotulluese.

Rezerva rrotulluese është një kapacitet i pangarkuar i gjenerimit, i cili është i sinkronizuar në sistem dhe është gati të sigurojë rritje të gjenerimit në mënyrë automatike ose me urdhër të dispeçerisë qendrore të sistemit elektroenergjetik në përgjigje të rënies së frekuencës.

Shërbimi i rezervës rrotulluese është i nevojshëm për t'i shërbyer ngarkesës menjëherë në rast të ndonjë ngjarjeje të paparashikuar në sistem.

Madhësia e rezervës operuese rrotulluese përcaktohet në Kodin e Transmetimit. OST-ja është përgjegjëse për sigurimin e këtij shërbimi.

SHTOJCA F
DETYRAT KRYESORE QË KËRKOHEN PËR ZBATIMIN E MODELIT SHQIPTAR TË
TREGUT

Institucionet dhe entet përgjegjëse të përcaktuara në këtë model tregu do të marrin masa për zbatimin në përgjithësi të këtij modeli dhe në veçanti për:

Rishikimin dhe harmonizimin e akteve ligjore në fuqi;

Rishikimin dhe harmonizimin e rregullave të tregut;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Shpërndarjes;

Rishikimin dhe harmonizimin e Kodit të Transmetimit;

Përgatitjen dhe miratimin e kontratave tip për transaksionet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut;

Përgatitjen e rregullave dhe protokollit të likuidimeve për të rregulluar çështjet e mospagesave ose pagesave të pjesshme nga pjesëmarrësit e tregut;

Shpejtimin e reformës për ristrukturimin dhe ndarjen e veprimtarive në sektorin elektroenergjetik;

Koordinimin me veprimtaritë e privatizimit;

Instalimin e matjes së duhur për të siguruar informacion të qëndrueshëm rreth të gjitha transaksioneve;

Zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të kontabilitetit;


Përgatitjen dhe zbatimin e protokolleve të fluksit të informacionit;

Instalimin e teknologjive të informacionit që kërkohen për informacion të sigurt të tregut;

Zhvillimin dhe miratimin e tarifave të bazuara në kosto për shërbimet e transmetimit dhe shpërndarjes.

Shtojca B


Shtojca B



Struktura e Tregut

Shtojca C

Marrëveshjet e Shërbimit të Transmetimit dhe të Shpërndarjes
përfshirë dhe Shërbimet Ndihmëse




Shënim 1. Ato Klientë të Kualifikuar të lidhur në sistemin e shpërndarjes do të duhet të hyjnë në marrëveshje me shoqërinë që u shërben atyre lidhur me shërbimet e lidhjes dhe shpërndarjes.

2. Të gjitha keto marrëveshje janë të rregulluara nga ERE.

Struktura e Tregut

Shtojca D

Marrëveshjet e Furnizimit me Energji




* Të rregulluar nga ERE

STRUKTURA E TREGUT

Likujdimet – Fluksi i Fondeve

Shtojca E



Shënim 1: Pagesat sipas Kontratave Vjetore të Rregulluara të Furnizimit me Energji Elektrike: Pagesat për Energjinë Elektrike të Blerë Jashtë Kontratave

Shënim 2: Pagesat sipas Tarifave të Përdorimit të Sistemit të Shpërndarjes

TABELA E PËRPUTHSHMËRISË në zbatim të VKM nr.201, datë 29.03.2006, (versioni sipas pikës 4.1.).

1. Projekt-Akti synon të transpozojë dispozitat e legjislationit të BE-së të evidentuara, si të detyrueshme në Direktiven 2003/54/EC botuar në Fletoren Zyrtare. Ai ekzekuton dispozitat e direktivës të sipërcituar përsa i takon përcaktimit të rregullave të funksionimit të tregut të brendshëm të energjië elektrike"				
2. Per miratimin e Modelit Shqiptar te Tregut te Energjië Elektrike				
3. Përafrim i pjesshëm i Direktivës 2003/54 (KE), nëpërmjet transpozimit të përmbajtjes së parimeve dhe neneve te kesaj direktive				
a.	b.	c.	d.	e.
Ne direktiven 2003/54 Neni 8 dhe neni 9. Qellimi i Operatorit te Sistemit te Transmetimit dhe detyrat qe kryen përcakton detyrat e OST ku jep se ky operator duhet te kryej transmetimin e energjië elektrike, perputhjen e kërkeses me furnizimin, menaxhimin e flukseve te energjis, pra dispecimin e tyre, si dhe operatorin e tregut si dhe zhvillimin e rrjetit te transmetimit. Neni 13 -Qellimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes qe përcakton se OSSH eshte pergjegjes per shperndarjen e energjië elektrike, te siguroje mirembajtjen e rrjetit qe disponon, zhvillon dhe miremban rrjetin shpermdares. Neni 23. pika 1 Autoriteti Rregullator Qe përcakton se ai eshte nje strukture e pavarur nga interesat e industrisë elektrik dhe eshte pergjegjes per funksionimin e tregut duke siguruar jo-diskriminimin, efektivitet dhe kompeticion Neni 9. (a)- Detyrat e Operatorit te Sistemit te Transmetimit ku përcaktohet se : OST siguron aftesine e sistemit per te mbajtur kapacitetet e sistemit te transmetimit ne perputhje me kërkesen afatgjate. Neni 12. - Konfidencialiteti ne Operatorin e Sistemit te Transmetimit përcakton se OST duhet te rruaj konfidencialitetin e informacionit dhe te punoje ne menyre jodiskriminuese. Neni 11. – Dispecimi dhe ballancimi përcakton se furnizimi i elektricitetit behet ne baze te detyrimeve kontraktuale OST ka detyre te kryejë dispecimin e instalimeve gjeneruese dhe te perdore interkonjeksionet sipas kriterëve te përcaktuara	1.Në Modelin Shqiptar te Tregut te Energjië Elektrike, pjese e Projekt-Vendimit, "Per miratimin e Modelit Shqiptar te Tregut te Energjië Elektrike" 4.1 OST –ja eshte shoqeri e pavarur shtetërore qe kryen keto funksione: Operimin e rrjetit te transmetimit nga pikpamja fizike (posedim, mirembajtje dhe zgjerim) (ORrT); Operatorin e Sistemit nga pikepamja e dispecerimit (OS); Operatorin e Tregut (duke siguruar qe informacioni per likuidimin e kontratave eshte i disponueshem, qe me pas mund te sherbeje si nje burse e energjië elektrike). 4.7 - Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH) OSSH-ja zoteron, miremban, zgjeron dhe operon sistemin e shperndarjes ne te gjithë Shqiperine. OSSH/Furnizuesi Publik ka pergjegjesi per blerjen e energjië elektrike per furnizimin pa nderprerje te klienteve tarifore. OSSH/Furnizuesi Publik ka pergjegjesine si furnizues publik qe te sherbeje si sigures i alternativës se fundit per te gjithë klientet. 4.10 - Rregullatori i Pavarur (ERE) ERE-ja eshte pergjegjese: a) per përcaktimin e te drejtave dhe detyrimeve respektive te pjesemarresve te tregut sipas rregullave dhe rregulloreve transparente dhe jo diskriminuese qe sigurojne aksesin e paleve te treta; (Qe eshte ne vartesi te Kuvendit përcaktohet ne ligjin nr. 9072, date 22.5.2003 „Per sektorin e energjië elektrike" 5.1. Parashikimi Afatgjate: OST-ja ka per detyre te pergatitise parashikime 15-vjecare per nevojat e vendit per energji elektrike. OST-ja eshte e detyruar te ruaje konfidencialitetin e informacionit te siguruar nga pjestarët e tregut ne ato raste kur nxjerrja e tij demton konkurrencen. 5.2 Kontrata e Furnizimit te nje Viti ne Avance Marredheniet dhe roli i pjesmarresve te tregut ne operimin fizik te Modelit te Tregut bazohet ne kontrata dypaleshe mes pjesmarresve te ndryshem ne perputhje me përcaktimet e meposhteme OST-ja blen nepermjet kontrates se sherbimeve ndihmese, sherbimet qe i nevojiten sistemit ne perputhje me parashikimet qe i dergohen asaj nga OSSH/Furnizuesi Publik dhe Klientet e Kualifikuar.	Përafrimi i pjesshëm		

Neni 9. (c) tek detyrat e OST percaktohet se OST ka detyre te menaxhoje flukset e energjise ne sistem duke llogaritur dhe shkembimet me interkonjeksion eshte pergjegjes per te garantuar siguri te furnizimit.dhe Neni 23. 2 (a) Autoriteti Rregullator, percakton se ai eshte pergjegjes per percaktimin e metodologjive dhe tarifave ne rrejetin nacional. Tarifat dhe metodologjite duhet te lejojne investimet e nevojeshme per garantuar pune te sigurte te rrejetit. Tek neni 20 percaktohet se metodologjite dhe tarifat duhet te jene jodiskriminuese brenda kategorive te ndryshme te konsumatoreve. Parimet baze te direktives, pika 24. percakton se konsumatorët familjare dhe ndermarjet e vogla, kur shihet e arsyeshme, gjejne te drejten te furnizohen me energji elektrike me çmime te krahasueshme, transparente dhe te kenaqeshme. Ne nenin 23 percaktohet se tarifat percaktohen nga ERE Neni 23. 1.Autoriteti Rregullator Qe percakton se ai eshte nje strukture e pavarur nga interesat e industrise elektrike dhe eshte pergjegjes per funksionimin e tregut duke siguruar jo-diskriminimin, efektivitet dhe kompeticion Neni 23. b Percakton se se duhet te kete mekanizma ne rastet e transmetimeve te ngarkesave shume te medha dhe te linjave te mbi ngarkuara dhe Neni 20. Aksesi i Paleve te Treta percakton se duhet siguruar akses i Paleve te Treta ne transmetim ne menyre jodiskriminuese. Neni 23. 1. d. percakton se duhet te publikohen informacione lidhur me kapacitetet ne transmetim dhe shperndarje por pa shkelur parimet e konfidencialitetit 23.2.b percakton se duhet te parashikohet sherbimi i balancimit dhe 23.3 percakton se duhet te percaktohen rregulla, metodologji dhe tarifa per kete qellim	OST-ja ka pergjegjesine te dispeceroje te gjitha njesite ne zoterim te KESH Gen-it, te PPE-ve, Treguesve dhe Furnizuesve te Kualifikuar dhe te respektojte te gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara ne rregullat e tregut 5.6 - OST-ja do te krahasoje shumen e parashikimeve te ngarkeses te marre nga pjestaret e tregut me parashikimet e saj dhe te vendose se cfare hapash te metejshem (p.sh blerje) mund te jene te nevojshme per te balancuar sistemin. 7. - Operimet e Shperndarjes OSSH/Furnizuesi Publik i propozon ERE-s tarifat e sherbimeve te furnizimit dhe shperndarjes ne menyre qe çdo klient tarifar brenda te njejtës klase klientesh ne te gjithë vendin te paguaje te njejtën tarifë te njehsuar. OSSH-ja i siguron sherbimin e shperndarjes klienteve te kualifikuar sipas tarifave te perdorimit te Sistemit te Shperndarjes te miratuara nga ERE-ja. OSSH-ja do te perdore te njejtën metodologji per te llogaritur tarifen e perdorimit te Sistemit te Shperndarjes, qe ajo perdor per llogaritjen e tarifave per klientet tarifarë. OSSH/Furnizuesi Publik do t'ia propozojte te ndare ERE-s tarifen e sherbimit te shperndarjes nga tarifat e furnizimit te klienteve tarifarë. 7. Operimet e Shperndarjes OSSH/Furnizuesi Publik i propozon ERE-s tarifat e sherbimeve te furnizimit dhe shperndarjes ne menyre qe çdo klient tarifar brenda te njejtës klase klientesh ne te gjithë vendin te paguaje te njejtën tarifë te njehsuar. OSSH-ja i siguron sherbimin e shperndarjes klienteve te kualifikuar sipas tarifave te perdorimit te Sistemit te Shperndarjes te miratuara nga ERE-ja. 8. Roli i Rregullatorit te Pavarur ERE ERE-ja e ushtron veprimtarine e saj ne baze te ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" me te gjitha ndryshimet. Funksionimi i rregullatorit te pavarur permbush kerkesat e Direktives së BE-së 2003/54 8.b. -Aksesi i Paleve te Treta. Prioriteti në sistemin e transmetimit ose e menaxhimit të bllokimeve kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t'i përballojnë të gjitha kërkesat e Klientëve Tarifarë dhe atyre të Kualifikuar. Nje çeshtje tjetër që duhet trajtuar në Kodin e Transmetimit dhe Rregullat e Tregut eshte ajo se si do të ndahet mungesa e kapaciteteve mes Klientëve Tarifarë dhe Klientëve të Kualifikuar në mënyrë që të implementohet nga OST-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur dhe jo-diskriminues 8. d. Në mënyrë që tregu të arrijë objektivat e tij, ERE-ja dhe, në shumë raste OST-ja, duhet të kenë akses të mjaftueshëm në informacionin lidhur me operimet, kostot, si dhe termat dhe kushtet e kontratave ndërmjet palëve. 8. h. Shërbimi i Disbalancës së Energjisë sigurohet kur ka një diferencë ndërmjet sasisë së prodhimit që është programuar një ditë më parë ose që është prodhuar në kohë reale dhe të konsumit (ngarkesës) në kohë reale.	
--	---	--

VENDIM
Nr.57, datë 11.10.2007

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIM, INSTALIM DHE SHFRYTËZIM TË
CENTRALIT ELEKTRIK, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KY
CENTRAL SHOQËRISË “REMI” SHPK**

Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, germa “a”, neni 15, pika 3, si dhe “Rregullores për procedurat e licencimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale”, me ndryshimet përkatëse, neni 4, pika 1, neni 13, pika 3, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.10.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Remi” sh.p.k. për marrje licence për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ky central,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për ndërtimin, instalimin e HEC Egnatia dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ky HEC, shoqërisë “Remi” sh.p.k., me kusht që:

a) Shoqëria “Remi” sh.p.k. të plotësojë dokumentacionin ligjor në zbatim të nenit 5 të kontratës së koncesionit.

b) Afati kohor për realizimin e këtij kushti të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e miratimit të licencës së kësaj shoqërie nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

c) Mosplotësimi i kushtit të përcaktuar në pikën 1, gjerat “a” dhe “b” të këtij vendimi sjell pavlefshmërinë e licencës.

2. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 17.10.2007
Doli nga shtypi më 19.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë